

Aneksi A

N r.	Pozicioni i punës	Struktura e intere-suar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Teknik i mesëm (Elektriçist/agrekatist)	4007, KM	Pezë-Helmës, Tiranë	3-mujore	po	jo	29.01.2025	31.12.2025

SHPALLJE VENDI I LIRË PUNE

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës: Teknik i mesëm (Elektriçist/agrekatist)
2. Kodi i pozicionit: A-066, B, 03, 006, LR 2477
3. Reparti/Institucioni: RU 4007, Komanda Mbështetëse
4. Vendi: Pezë-Hemës, Tiranë
5. Paga: Sipas VKM-së, nr.326, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Për një kohëzgjatje të përcaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit: 29.12.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 31.12.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): <i>Degës së Personelit</i> <i>Komandës Mbështetëse</i> <i>Ferraj</i> <i>Tiranë</i>
10. Dokumentet e aplikimit: Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: ▪ kërkesën; ▪ formularin e aplikimit; ▪ fotokopje të kartës së identitetit; ▪ diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal; ▪ fotokopje të patentës; ▪ dëshmi profesioni nëse ka; ▪ certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja ▪ raport mjekësor; ▪ fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; 9x12, 2 copë. ▪ dëshmi penaliteti; ▪ vërtetim nga gjykata; ▪ vërtetim nga prokuroria; ▪ librezë pune; ▪ jetëshkrimin (CV).

- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www. mod.gov.al](http://www.mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- të ketë shtetësinë shqiptare;
- të jetë jo më pak se 25 vjeç;
- të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli:Civil
- Arsimi : I Mesëm
- Kualifikimi: Të jetë i aftë në realizimin e detyrave dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së batalionit të transportit.
- Eksperienca në Punë: Mbi 3 vjet

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga: Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- vlerësimin e trajnimeve;
- vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- jetëshkrimi, 5 pikë;

- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimmarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

Faleminderit për mirëkuptimin.